

Shoqata e kontabilistëve të certifikuar dhe auditorëve të  
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Kontabiliteti Financiar**  
**Financial Accounting**

**P1**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data 18.07.2020

## Problemi 1

Draft pasqyrat financiare të Kompanisë Alfa, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2019 treguan fitim prej €122,400. Bilanci vërtetues nuk u barazua dhe llogaria pezull me saldo kredi €8,310 ishte përfshirë në pasqyrën e bilancit të gjendjes.

Gjatë një kontrollimi të mëvonshëm ishin gjetur gabimet e mëposhtme:

- (a) Zhvlerësimi i automjeteve me një normë 15 përqind ishte llogaritur për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2019 me metodën drejtvizore, por ishte dashur që të llogaritej me metodën e saldove zbritëse me normë 15 përqind. Këto janë të dhënat relevante:  
Kostoja e automjeteve €240,000, vlera neto në libra më 1 janar 2019, €95,000
- (b) Qiraja e arkëtuar nga lëshimi i një pjese të zyrës për tre muajt e kaluar në shumë prej €2,200 ishte vendosur në kasafortën e parave të imëta (Pettycash). Për këtë transaksion nuk është bërë asnjë regjistrim as një librin e arkës e askund tjetër. Gjendja e parasë së imët në bilancin vërtetues ishte sipas regjistrave, që është €2,200 më e ulët se gjendja reale në kasafortë.
- (c) Duhet të shlyhen borxhet e këqija prej 2,600 eur.
- (d) Kompania kishte bërë shpenzimet për riparimin e automjeteve në shumë prej 8,400 eur. Marrëveshja me kompaninë e riparimit të automjeteve ishte që pagesa të bëhej në vitin e ardhshëm 2020. Regjistrimi i vetëm sa i përket këtij transaksioni ishte në konton shpenzimet e riparimeve, sepse kontabilisti nuk e kishte shiquar kontratën se cilat janë kushtet e pagesës, andaj ishte i pasigurtë për këtë veprim.
- (e) Zbritjet në para të gatshme për dhjetorin e 2019 nuk ishin paraqitur në llogaritë e zbritjeve në librin kryesor.

Të dhënat ishin:

	€
Zbritjet e lejuara	420
Zbritjet e pranuar	330

Pas regjistrimeve të nevojshme, llogaria pezull u barazua.

### *Kërkohet*

**Përgatitni regjistrimet në ditar, me përshkrime, për të korigjuar gabimet e gjetura dhe përgatitni një pasqyrë që tregon korigjimet e nevojshme për fitimin**

**[Total: 10 pikë]**

## Zgjidhja e problemit 1

### Regjistrimet në ditar:

(a) Kalkulimi i gabuar:

$$\text{Zhvlerësimi vjetor} = 15\% \times \text{Kosto} = 15\% \times 240,000 = 36,000$$

Kalkulimi i saktë:

$$\text{Zhvlerësimi vjetor} = 15\% \times \text{VNL} = 15\% \times 95,000 = 14,250$$

Me qenë se është regjistruar shumë më e lartë e zhvlerësimit se sa që ka qenë shuma e saktë, duhet korigjuar diferencën prej  $36,000 - 14,250 = 21,750$  në ditar si në vijim:

D Zhvlerësimi i akumuluar      21,750

        K Shpenzimet e zhvlerësimit                      21,750

(b) D Paraja e imët (Petty cash)    2,200  
        K Qeraja e arkëtueshme    2,200

(c) D Shpenzimet e borgjeve të këqija    2,600  
        K Llogarite kontrolluese të të arkëtueshmeve    2,600

(d) D Llogaria pezull    8,400  
        K Akrualet për Riparimet e mjeteve motorike    8,400

(e) Zbritjet e lejuara    420  
    Zbritjet e pranuar    330  
    Llogaria pezull    90

### Pasqyra e fitimit e rregulluar

	€
Draft fitimi	122,400
Diferenca e zhvlerësimit	21,750
Borxhi i keq	(2,600)
Shpenzimet e riparimeve	8,400
Zbritjet e lejuara	(420)
Zbritjet e pranuar	330
Fitimi i korigjuar	<u>149,860</u>

### LLOGARIA PEZULL

	€		€
Riparimet e motorit	8,400	Saldo në fillim	8,310
		Zbritjet	90
	<u>8,400</u>		<u>8,400</u>

## Problemi 2

Arta Sh.P.K. është një prodhues i produkteve të betonit për industrinë e rrugëve dhe llogaritë e tij janë si më poshtë:

### Pasqyra e Pozitës Financiare e Arta Sh.P.K. më 31 dhjetor 2019

	2019	2018
	€'000	€'000
<b>Pasuritë jo-qarkulluese</b>		
Prona, Fabrika & Pajisjet	66,300	55,600
Kostot e Zhvillimit	4,360	200
Prona Investuese	<u>20,200</u>	<u>20,000</u>
<b>Total Pasuritë jo-qarkulluese</b>	<u>90,860</u>	<u>75,800</u>
<b>Pasuritë qarkulluese</b>		
Stoqet	8,900	9,200
Të arkëtueshmet tregtare	14,320	12,300
Paraja e gatshme	<u>2,130</u>	<u>-</u>
<b>Total Pasuritë qarkulluese</b>	<u>25,350</u>	<u>21,500</u>
<b>Total Pasuritë</b>	<u>116,210</u>	<u>97,300</u>
<b>Ekuiteti &amp; Detyrimet</b>		
<b>Ekuiteti</b>		
Kapitali Aksionar	72,000	60,000
Premia	9,600	8,000
Fitimet e mbajtura	2,620	590
Rezerva e Rivlerësimit	<u>2,800</u>	<u>800</u>
<b>Total Ekuiteti</b>	<u>87,020</u>	<u>69,390</u>
<b>Detyrimet afatgjata</b>		
Kredia Bankare	<u>18,500</u>	<u>12,100</u>
<b>Total Detyrimet afatgjata</b>	<u>18,500</u>	<u>12,100</u>
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>		
Të pagueshmet tregtare	9,340	10,050
Overdrafti Bankar	-	4,560
Tatimi i pagueshëm	<u>1,350</u>	<u>1,200</u>
<b>Total Detyrimet afatshkurtra</b>	<u>10,690</u>	<u>15,810</u>
<b>Total Ekuiteti &amp; Detyrimet</b>	<u>116,210</u>	<u>97,300</u>

**Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për Arta Sh.P.K. për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019**

	€'000
Të hyrat	23,400
Kosto e shitjes	<u>(18,910)</u>
Fitimi Bruto	4,490
Shpenzimet e shpërndarjes	(1,129)
Shpenzimet administrative	(891)
Shpenzimet e interesit	(450)
Të hyrat nga interesi	<u>357</u>
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>2,377</b>
Shpenzimet e tatimit në Korporata	<u>(297)</u>
<b>Fitimi për vitin</b>	<b>2,080</b>

**Shënime:**

- i. Prona, Fabrika & Pajisjet me vlerë në libra prej 2,050,000€ ishte shitur për 1,800,000€.
- ii. Zhvlerësimi për vitin për Pronën, Fabrikën & Pajisjet ishte në vlerë prej 2,150,000€.
- iii. Dividendët e paguar gjatë vitit ishin €50,000.

**Kërkohet:**

Përgatitni Pasqyrën e Rrjedhës së Parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019 për Arta Sh.P.K.

**(Total: 20 pikë)**

## Zgjidhja e problemit 2

### Pasqyra e Rrjedhës së Parasë për Arta Sh.P.K. për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019

	€'000	€'000
<b>Rrjedha e parasë nga Aktiviteti Operativ</b>		
Fitimi para tatimit	2,377	
Rregullimet për:		
Zhvlerësimi	2,150	
Humbja në shitjen e P.F.P.	250	
Shpenzimet e interesit	450	
Të hyrat nga interesi	-357	
Rritja në LI/A	-2,020	
Zvogëlimi në stoqe	300	
Zvogëlimi në LL/P	-710	
Keshi i gjeneruar nga operimet	2,440	
Interesi i paguar	-450	
Interesi i arkëtuar	357	
Tatimi i paguar	-147	
<b>Rrjedha neto e parasë nga Aktiviteti Operativ</b>		<b>2,200</b>
<b>Rrjedha e parasë nga Aktiviteti Investues</b>		
Blerja e Pronës, Fabrikës & Pajisjeve	-12,900	Shënimi 1
Kostot e zhvillimit të kapitalizuara	-4,160	
Blerja e pronës investuese	-200	
Shitja e Pronës, Fabrikës & Pajisjeve	1,800	
<b>Rrjedha neto e parasë nga Aktiviteti Investues</b>		<b>(15,460)</b>
<b>Rrjedha e parasë nga Aktiviteti Financues</b>		
Hyrje e parasë nga emetimi i aksioneve	13,600	
Hyrje e parasë nga rritja e kredive bankare	6,400	
Dividenda e paguar	-50	
<b>Rrjedha neto e parasë nga Aktiviteti Financues</b>		<b>19,950</b>
Rritja neto në kesh dhe ekuivalentë të keshit	6,690	
Keshi dhe ekuivalentët e keshit në fillim të vitit Shënimi 1	-4,560	
Keshi dhe ekuivalentët e keshit në fund të vitit Shënimi 1	2,130	
<b>Shënim</b>	2010	2009
	€'000	€'000
Keshi në dorë dhe gjendjet në banka	2,130	-
Overdrafti bankar	-	-4,560
Keshi dhe ekuivalentët e keshit	2,130	-4,560

Shënimi 1:

PIP (VNL)

Saldo në fillim	55,600	Shitja	2,050
		Zhvlerësimi	2,150
Rivlerësimi	2,000		
<b>Blerja (Shifër balancuese)</b>	<b>12,900</b>		
Saldo në fund	66,300		

### Problemi 3

Llogaria Kontrolluese e të Arkëtueshmeve të Aurora më 31 dhjetor 2008 kishte një saldo prej €105,250; përderisa Llogaria Kontrolluese e të Pagueshmeve kishte një saldo prej €87,180. Asnjëra nga këto saldo nuk ishin në përputhje me listën e saldove individuale.

Gjatë investigimit të diferencës, janë zbuluar çështjet e mëposhtme:

- a) Libri i shitjeve ditore ishte nënvlerësuar prej €1,400.
- b) Bilanci prej €2,500, borxh i arkëtueshëm nga Silvia ishte lënë jashtë nga lista e saldove individuale.
- c) Borxhi i keq prej €2,100 ishte shlyer nga Libri analitik i të arkëtueshmeve por asnjë regjistrim nuk ishte bërë në Llogarinë Kontrolluese.
- d) Një blerje e mallrave nga Gentrity prej €5,500 ishte regjistruar në anën e gabuar të librit analitik të tij.
- e) Mallrat me vlerë prej €3,300 të cilat i janë kthyer furnitorit nuk janë regjistruar fare në libra.
- f) Një faturë prej €660 është regjistruar në Librin Ditor të Shitjeve si €606 edhe në listat individuale.
- g) Kishte rëndë dakord me Donin për të regjistruar saldon në konton e tij në librin analitik të të pagueshmeve prej €2,750 kundër llogarisë së tij (kontra regjistrimet) në librin analitik të të arkëtueshmeve. Sidoqoftë, kjo ishte regjistruar vetëm në listat individuale të të arkëtueshmeve dhe të pagueshmeve.
- h) Gjatë dhjetorit të vitit 2008, kthimet nga shitjet prej €1,800 ishin regjistruar në Llogarinë Kontrolluese si €800.
- i) Libri i blerjeve ditore ishte mbivlerësuar prej €750.
- j) Një kthim i shitjes prej €780 ishte regjistruar në anën kreditore të llogarisë së Martit në librin analitik të të pagueshmeve.
- k) Saldo prej €1,300 ishte lënë jashtë nga lista e saldove të llogarive të pagueshme.

#### KËRKOHET:

- a) Përgatitni një llogaritje të saldove të sakta që duhet të regjistrohen në Llogaritë Kontrolluese të të Arkëtueshmeve dhe të Pagueshmeve. **(10 Pikë)**
- b) Përgatitni një deklaratë të harmonizimit të saldove në llogaritë kontrolluese me saldote e korrigjuara në listat individuale (Librat analitik). Gjeni sa janë saldote e pakorrigjuara në listat individuale.

**(10 Pikë)**  
**[Totali: 20 Pikë]**



### Zgjidhja e problemit 3

a)

#### Llogaria Kontrolluese e të Arkëtueshmeve

Data	Përshkrimi	Vlera (€)	Data	Përshkrimi	Vlera (€)
Dhj.			Dhj.		
31	Saldo	105,250	31	c)Borxhi i keq	2,100
31	a)Libri i shitjeve ditore	1,400	31	g)Kundër regjistrimi	2,750
31	f)Gabimi në L.Sh.D. (660-606)	54	31	h)Kthimet (1,800-800)	1,000
31				Saldo balancuese	<u>100,854</u>
		<u>106,704</u>			<u>106,704</u>
	Saldo e korigjuar	<u>100,854</u>			

#### Llogaria Kontrolluese e të Pagueshmeve

Data	Përshkrimi	Vlera (€)	Data	Përshkrimi	Vlera (€)
Dhj			Dhj		
31	e)Kthimet	3,300	31	Saldo	87,180
31	g)Kundër regjistrimi	2,750			
	i)Libri i blerjeve ditore	750			
31	Saldo balancuese	<u>80,380</u>			
		<u>87,180</u>			<u>87,180</u>
			Saldo e korigjuar		<u>80,380</u>

b)

**Lista e saldove të Llogarive të Arkëtueshme**

	€
Saldo origjinale (Shifër balancuese)	99,080
b) Saldo e lënë jashtë	2,500
f) Gabimi i Librit të Shitjeve Ditore (660-606)	54
j) <u>Kthimi i shitjes</u>	<u>(780)</u>
Saldo e korigjuar	100,854

**Lista e saldove të Llogarive të Pagueshme**

	€
Saldo origjinale (Shifër balancuese)	72,160
d) Gentrir (5,500 x 2)	11,000
e) Kthimet	(3,300)
j) Marti	(780)
k) <u>Saldo e lënë jashtë</u>	<u>1,300</u>
Saldo e korigjuar	80,380

#### Problemi 4

Petriti ka mbajtur në zotërim 75% të kapitalit aksionar të ekuitetit të Merita shpk për disa vite. Pasqyrat e përmbledhura të të ardhurave për Petritin dhe Meritën për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2019 paraqiten më poshtë:

#### PASQYRA E TË ARDHURAVE ME 31 DHJETOR 2019

	<i>Petriti</i>	<i>Merita</i>
	€	€
Të hyrat nga shitja	350,000	500,000
Kostoja e shitjeve	<u>150,000</u>	<u>400,000</u>
Fitimi bruto	200,000	100,000
Shpenzimet administrative	<u>40,000</u>	<u>25,000</u>
Fitimi para tatimit	160,000	75,000
Shpenzimet e tatimit në të ardhura	<u>10,000</u>	<u>5,000</u>
Fitimi për periudhën	<u>150,000</u>	<u>70,000</u>

Përgjatë vitit, Petriti shiti mallra të cilat kushtuan €12,000 ndaj Meritës me një marzhë shtim mbi kosto prej 25%. Në fund të vitit, 30% e këtyre mallrave mbesin në stoqe.

*Kërkohet*

**Përgatitni pasqyrën e të ardhurave të konsoliduar për grupin Petriti më 31 dhjetor 2019.**

**Totali 20 pikë**

## Zgjidhja e problemit 4

GRUPI Petriti shpk

PASQYRA E TË ARDHURAVE E KONSOLIDUAR ME 31 DHJETOR 2019

	€
Të ardhurat (350 + 500 - 15(LI))	835,000
Kostoja e shitjeve (150 + 400 - 15(LI) + 0.9(LI))	<u>(535,900)</u>
Fitimi bruto (200 + 100 - 0.9(LI))	299,100
Shpenzimet administrative (40 + 25)	65,000
Fitimi para tatimit	234,100
Shpenzimet e tatimit në të ardhura (10 + 5)	15,000
Fitimi për periudhën	<u>219,100</u>
I atribuohet:	
Mbajtësve të ekuitetit të kompanisë mëmë (sh. bal.)	201,600
IJK (25% × 70)*	<u>17,500</u>
	<u>219,100</u>

*Llogaritjet*

Shitjet brenda grupit

		€
Çmimi i shitjes	125%	15,000
KMSH	<u>100%</u>	<u>(12,000)</u>
Fitimi bruto	25%	3,000
Fitimi i porealizuar $30\% \times 3,000 = 900$		900

\* Për shkak që shitja është bërë nga kompania mëmë Petriti, ndaj filialës Merita, nuk ka fitim të porealizuar që i takon IJK-së.

## Problemi 5

Arta shpk. është një kompani që merret me prodhimin e pajisjeve për industrinë e hotelerisë. Në vazhdim është paraqitur Bilanci Vërtetues i marrë nga librat më 31 Dhjetor 2018:

	<b>Debi</b>	<b>Kredi</b>
	<b>€</b>	<b>€</b>
Zhvlerësimi i akumuluar - Ndërtesat - 1 Janar 2018		124,000
Shpenzimet Administrative	126,200	
Llogaritë e Arkëtueshme Tregtare	142,600	
Fitimi i mbajtur - 1 Janar 2018		737,720
Blerjet	687,300	
Lejimet për të Arkëtueshmet		6,780
Kredi afatgjatë		150,000
Banka	180,400	
Kapitali Aksionar - €1 për aksion		100,000
Ndërtesat - Kosto më 1 Janar 2018	648,200	
Stoqet më 1 Janar 2018	126,430	
Tatime të pagueshme - 1 Janar 2018		6,840
Zhvlerësimi i Akumuluar - Automjete - 1 Janar 2018		38,500
Shpenzimet e Shpërndarjes	245,200	
Shpenzimet financiare	12,400	
Zhvlerësimi i Akumuluar - Makineri & Pajisje - 1 Janar 2018		64,750
Llogari të Pagueshme Tregtare		102,140
Rezerva e Rivlerësimit		25,000
Të hyrat nga shitja		1,245,100
Makineri dhe Pajisje - Kosto më 1 Janar 2018	245,700	
Automjetet - Kosto më 1 Janar 2018	186,400	
<b>TOTALI</b>	<b>2,600,830</b>	<b>2,600,830</b>

**Bazuar në hetimet tuaja, keni gjetur informacionin në vazhdim:**

- (i) Stoqet janë numëruar dhe vlerësuar më 31 Dhjetor 2018 në shumën €132,600. Përfshirë në këtë shumë janë edhe €2,500 stoqe me kosto të cilave iu ka rënë vlera. Shitjet e pas-fund vitit tregojnë që këto shpesh janë shitur pas fund-vitit me një çmim të barabartë me 80% të kostos së tyre, pra sipas vlerës së tregut. Humbja nga rënia në vlerë e stoqeve është përfshirë te shpenzimet administrative.
- (ii) Gjatë Janarit 2018, u kuptua që saldo në fund e stoqeve më 31 Dhjetor 2017 janë mbivlerësuar për €3,100.
- (iii) Zhvlerësimi ngarkohet si në vazhdim:

Ndërtesat	2%	Metoda Drejtvizore
Makineri dhe Pajisje	10%	Metoda Drejtvizore
Automjete	24%	Metoda e saldosh zbritëse

Zhvlerësimi për vitin ngarkohet plotësisht në vitin e blerjes dhe nuk ngarkohet zhvlerësim në vitin e shitjes.

- (iv) Ndërtesat u rivlerësuan në shumën €575,000 më 31 Dhjetor 2018.
- (v) Në Tetor 2018, kompania pagoi tatime në shumën prej €12,000. Shpenzimet e tatimit për vitin janë €7,000.
- (vi) Një klient ka shpallur likuidimin dhe saldo e llogarisë së klientit prej 5,600 € është shlyer. Lejimet për Llogaritë e Arkëtueshme përcaktohen në 5%.

**Kërkesat:**

**Përgatitni, në një formë të përshtatshme për publikim, bazuar në SNRF, Pasqyrën e të Ardhurave dhe Pasqyrën e Pozicionit financiar për Arta shpk, për vitin financiar që përfundon më 31 dhjetor 2018.**

**(30 pikë)**

## Zgjidhja e problemit 5

(i)	Stoqet pas numërimit		132,600
	Kosto e mallit ende ne stoqe	2,500	
	VNR - 80% e kostos	(2,000)	
	Shlyerja e Stoqeve		(500)
	<b>Vlera e Stoqeve në fund 31.12.18</b>		<b>132,100</b>

(ii)	Debi: Fitimi i mbajtur	3,100	
	Kredi: Stoqet		3,100

(iii)

	Ndërtesa	Makineri & Pajisje	Automjete	Total
Kosto	648,200	245,700	186,400	1,080,300
Zhvlerësimi i Akumuluar	-124,000	-64,750	-38,500	-227,250
Vlera Bartëse 01.01.2018	524,200	180,950	147,900	853,050
Zhvlerësimi i Ndërtesave 2%	-12,964	-	-	-12,964
Zhvlerësimi Makineri & Pajisje 10%	-	-24,570	-	-24,570
Zhvlerësimi i Automjeteve 24%	-	-	-35,496	-35,496
	511,236	156,380	112,404	780,020
Fitim nga rivlerësimi	63,764			63,764
Vlera Bartëse 31.12.2018	575,000	156,380	112,404	843,784

(iv)

Debi: Zhvl i akumuluar      136,964 (124,000+12,964)

Kredi Ndërtesa -Kosto

73,200 (648,200 -575,000)

Kredi: Rezerva e Rivlerësimit

63,764

v) Debi Shpenzimet e tatimit 7,000  
 Kredi Tatimi i pagueshëm 7,000

Debi Tatimi i pagueshëm 12,000  
 Kredi Paraja e gatshme 12,000

Tatimi i pagueshëm

	S`6,840
	Shpenzimet e tatimit 7,000
Paraja 12,000	
	S``1,840

(vi)

Debi: Shpenzimet e borxheve te keqija 5,600  
 Kredi: Llogari të Arkëtueshme Tregtare 5,600

Debi: Shpenzime e borxheve te dyshimta 70  
 Kredi: Lejime për të Arkëtueshmet 70

Llogari të Arkëtueshme Tregtare 142,600

Shlyerja e Borxhit të Keq (5,600)

137,000

Lejimet për të Arkëtueshmet 5%  
 (6,850)

Lejimet

	S` 6780
	Shpenzimet e BD 70
	S`` 6,850

KMSH= st. Fillim +blerjet -st fund=(126,430-3,100)+687,300-132,100=678,530



Pasqyra e të ardhurave për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2018

Të hyrat nga shitja	1,245,100	
KMSH	678,530	
<hr/>		
Fitimi Bruto	566,570	
Shpenzimet administrative	(126,200)	
Shpenzimet e shpërndarjes	(245,200)	
Shpenzimet e zhvlerësimit	(73,030)	(12,964+24,570+35,496)
Shpenzimet e borxheve të këqija dhe të dyshimta	(5,670)	(5,600+70)
Shpenzimet financiare	(12,400)	
<u>Shpenzimet e tatimit</u>	<u>(7,000)</u>	
Fitimi neto	97,070	

Pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2018

PASURITE

*Pasuritë jo qarkulluese*

Ndërtesat	575,000	
Makineri dhe pajisje-VNL	156,380	
Automjetet-VNL	112,404	
<b>Totali i pasurive jo-qarkulluese</b>		<b>843,784</b>

*Pasuritë qarkulluese*

Stoqet	132,100	
LI/ A	137,000	
<u>Lejimet</u>	<u>(6,850)</u>	
LI/ A neto	130,150	
Paraja (180,400-12,000)	168,400	
<b>Totali i pasurive qarkulluese</b>		<b>430,650</b>

**TOTALI I PASURIVE** **1,274,434**

**EKUITETI**

Kapitali aksionar	100,000
Rezerva e rivlerësimit (25,000+63,764)	88,764
Fitimi i mbajtur (737,720-3,100+97,070)	831,690

**TOTALI I EKUITETIT** **1,020,454**

**DETYRIMET**

Detyrimet afatgjata	
Kredi afatgjatë	150,000
Detyrimet afatshkurta	
LI/P	102,140
Tatimi i pagueshëm	1,840

**TOTALI I DETYRIMEVE** **253,980**

**TOTALI I EKUITETIT DHE DETYRIMEVE** **1,274,434**